

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 5 shtator 2005 | nr. 4 | www.vetevendosje.org



S e p s e

- Jo negociata sepse negociatat kanë kuptim kur zhvillohen mes palëve të barabarta. Kosova nuk është e barabartë me Serbinë. Kosova nuk është shtet sikur Serbia.
- Jo negociata sepse nuk janë zhbërë strukturat e Serbisë në Kosovë.
- Jo negociata sepse përveçqë Kosova e ka Serbinë në qafë, ajo e ka edhe UNMIK-un mbi kokë. Kosova sundohet nga regjimi antidemokratik i UNMIK-ut.
- Jo negociata sepse institucionet e sistemit që i ka krijuar dhe i kontrollon ky regjim, medoemos do të udhëhiqen prej njerëzve të korruptuar e të shantazhuar, të tillë çfarë janë sot në Kosovë.
- Jo negociata sepse përmes negociatave Serbia po tenton të përligj ambicjet e saj për të rivendosur kontrollin faktik mbi popullin dhe territorin e vendit tonë, madje duke bërë edhe ndarjen e tij.
- Jo negociata sepse ato po planifikohen për Kosovën, e jo edhe për Serbinë. Rezoluta 1244 do të jetë baza e negociatave, e, siç dihet, Rezoluta 1244 e ruan nominalisht sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe e nxist restaurimin faktik të tij.
- Jo negociata sepse negociatat nuk planifikohen të bëhen për të kërkuar përgjegjësi dhe dëmshpërblim nga Serbia për 12.000 të vrarë, 3.000 të rrëmbyer, 20.000 femra të dhunuara, një milion të dëbuar dhe 120.000 shtëpi të shkatërruara. Negociatat po parashikohen të bëhen për të kurorëzuar rehabilitimin e shtetit të Serbisë.
- Jo negociata sepse negociatat përfundimisht do ta barazojnë krimin dhe gjenocidin (shteti i Serbisë) me viktimën (populli i Kosovës); dhe, agresionin me luftën çlirimtare.

- Jo negociata sepse negociatat duhet të zhvillohen pa kushte. Vendi ynë po kushtëzohet: na janë vënë standarde për të plotësuar dhe parime të panegociueshme arbitrarë.
- Jo negociata sepse Serbia nuk u identifikua si agresor që ushtroi represion e terror për më se një shekull, por madje ajo pas rënies së Milosheviqit u rehabilitua; automatikisht (pa plotësuar standarde) u pranua në institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë.
- Jo negociata sepse Kosovës nuk i mungon statusi, por popullit të saj i mungon liria. I burgosuri nuk negocion.
- Jo negociata sepse ato pashmangshëm nënkuptojnë gatishmërinë për kompromis. Liria nuk është kompromis. Liria është e drejtë e pandërmjetësuar dhe gjendje e panegociueshme.
- Jo negociata sepse fillimi i negociatave paraqet fundin e pavarësisë dhe shtetësisë si mundësi. Serbisë i mjafton kjo, në mënyrë që pastaj negociatat të bëhen për autonomi territoriale të serbëve në Kosovë, e që nënkupton legalizimin e enklavave ekzistuese serbe në Kosovë, si dhe zgjerimin e tyre dhe krijimin e enklavave të reja. Një gjë e tillë veç ka filluar me decentralizimin.
- Jo negociata sepse me Serbinë mund të negociohet për shumëçka tjetër vetëm atëherë kur ajo të pranojë parakushtin e panegociueshëm - vullnetin e popullit të Kosovës.

Një revolucion që nuk prodhon hapësirë të re, ai nuk ka realizuar potencialin e tij të plotë; në të vërtetë, ai ka dështuar në atë që nuk ka ndryshuar vetë jetën, por vetëm ka ndërruar superstrukturat ideologjike, institucionet apo aparatat politike.

Henri Lefebvre

Editorial

Institucionet e Kosovës nuk mund ta hapin statusin si temë përveçse në negociata me Serbinë. Këtë e imponon pranimi i konceptit të standardeve para statusit. Nuk mund ta pranosh konceptin e standardeve para statusit, e të jesh kundër negociatave, meqenëse ky koncept e parasheh statusin si të negociueshëm. Në vitet '90, pavarësia nënkuptonte atë në të cilën bazohej - vullnetin e popullit të Kosovës të shprehur në referendumin e vitit 1991. Sot, nëpërmjet standardeve para statusit, pavarësia është degraduar në qëndrim fillestar të palës kosovare në negociatat me Serbinë. Pavarësi? S'ka problem, përgjigjet UNMIK-u, veçse eja e thuaje këtë në tryezë me Serbinë. Çdo i huaj në Kosovë që është për pavarësi të Kosovës, etiketohet si proshqiptar. Pavarësia ka mbetur vetëm qëndrim politik i njëanshëm. Vetëvendosja është parim i së drejtës. Negociatat që po përgatiten parashohin që Kosova e varur, e ndarë dhe josovrane të bisedojë me Serbinë për veten e saj. Në tavolinën e negociatave do të negociohet vetja jonë. Dhe atë me kë? Me Serbinë! As malazetë, të cilët luftuan krah për krah me serbët në ushtrinë jugosllave në të gjitha luftërat (Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Kosovë) nuk duan që Mali i Zi të mbetet me Serbinë. Kurse neve duan të na fusin në negociata drejt një kompromisi i cili si gjithëherë do të jetë më afër pozicionit të palës më të fuqishme. Nga ne kërkohet që jo vetëm ta durojmë shtypjen e vullnetit tonë, por edhe të heqim dorë prej tij.

Pjesa më e rëndësishme e këtyre negociatave është pjesa e panegociueshme e tyre. Ajo përcakton statusin e negociatorëve. Kuadri i ballafaqimit është esencial për rezultatin e ballafaqimit. Rezoluta 1244 - e cila e përmban dhe i referohet dokumentit të Rambujesë - pashmangshëm do të jetë ky kuadër, do të jetë platforma e bisedimeve sepse pikërisht aty edhe parashihen ato. Qëndrimet fillestare të palëve negociuese vdesin me fillimin e negociatave. Prandaj, fillimi i negociatave e garanton formulën 'më shumë se autonomi, më pak se pavarësi'. Në këtë mënyrë, fillimi i negociatave është më i rëndësishëm sesa ecuria e tyre. Kjo e fundit është lehtë e parashikueshme. Sa më shumë që do t'i japin autonomi Kosovës, kjo do të jetë e përcjellur me autonomi më të madhe të serbëve të Kosovës. (Pavarësia e Kosovës shpie në ndarje të saj, ama vetëm teorikisht, duke qenë se pavarësinë e parandalon fillimi i negociatave.) Kësisoj, enklavat nuk do t'i bashkohen Serbisë, sepse nuk planifikohet që Kosova të ndahet nga Serbia.

Sigurisht se po hyjmë në finalen e statusit. Por, cili do të jetë statusi i finales? Sërisht proces, në të cilin nuk kemi as ndikim dytësor; jemi edhe mbrapa Serbisë edhe mbrapa faktorit ndërkombëtar, në organizmat e të cilit Serbia e ka zërin e saj, por jo edhe ne. Zaten, atyre që janë më të dobët, nuk u hyjnë në punë proceset me të fuqishmit nga të cilët sundohen. Atyre u nevojitet akti i shkëputjes, si akt i lirisë. Referendumi është akti. Me procese, ai që është në avantazh fuqje gllabëron të tjerët. Ngadalë por sigurt. Me proces, as Mali i Zi nuk po arrin të shkëputet. Duke plotësuar standarde s'arrihen shtetësia e pavarësia.

E vetmja Serbi me të cilën ia vlen të negociohet, është ajo që e pranon vetëvendosjen për Kosovën. Pra, mund të negociohet me Serbinë, me të cilën s'do të ketë negociata në kuptimin e atyre që po gatuhen. Shpeshherë, negociatat me Serbinë dhe integrimi evropian përmenden në të njëjtën fjali. Ne e duam integrimin evropian dhe ndërvarësinë evropiane. Mirëpo, nuk mund të jemi të ndërvarur pa qenë njëherë të pavarur.

Aktualisht, qëndrimi i Serbisë i bën problemet çështje të luftës. Ne kishim një autonomi në ish-Jugosllavi, dhe e cila përveçse nuk na bënte dot të barabartë me popujt e tjerë, na u mor nga Serbia. Dhe tash, pas shumë humbjeve e vuajtjeve, pas shumë krimeve e shkatërrimeve që kreu, Serbia na ofron autonomi. E, UNMIK-u thotë se duhet të negociojmë me të. Lëvizja VETËVENDOSJE! po e ngrit këtë çështje jashtë këtyre negociatave dhe në kundërshtim me to. Qëndrimi ynë është se ne kemi status, nuk na mungon ai; neve na mungon liria. Çështja e Kosovës nuk është problem i një kontigjence politike, por i një nevojë njerëzore dhe popullore. Ne nuk jemi të lirë. Lëvizja jonë po e rrit vlerën shoqërore të lirisë. Kjo është e domosdoshme për realizimin e saj. Beteja jonë është betejë për një tjetër kontekst të betejave. Beteja jonë është zgjedhje fundamentale. Politikanët e Kosovës deklarativisht thonë se mund të negociojmë për gjithçka, përveç për statusin e Kosovës. Në fakt, nuk duhet negociuar për asgjë para realizimit të lirisë së Kosovës. Lirinë nuk na e sjell dilema se si të negociohet pavarësia, por pyetja se çfarë bëjmë në nëse nuk vjen ajo. Pra, jo iluzioni i garantimit të stabilitetit, por potenciali për destabilizimin e kësaj situatë të padrejtë. Kalimi i kohës është proces legjitimues. Këto gjashtë vite të mungesës së vazhdueshme të pavarësisë së Kosovës nën administrim ndërkombëtar, e kanë legjitimuar jopak këtë mungesë. Gatishmëria për kryengritje të re në rast kompromisi, e parandalon kompromisin.

Albin Kurti

Žižek-u, lifti dhe Kosova

Glauk Konjufca

Në një ligjëratë, filosofi virtuoz sloven, Slavoj Žižek, shpjegon të ashtuquajturin 'iluzion të zgjedhjes', mbi të cilin fundamentohet thelbi i lirisë në shoqëritë kapitaliste. Në të tilla shoqëri, liria është e reduktuar në 'zgjedhjen e mënyrës së të jetuarit'. Por, kjo s'është e gjitha: sistemi është ai, i cili, nëpërmjet mekanizmash të ndryshëm, kufizon lirinë e individit deri në këtë masë, për ta mbajtur atë nën kontroll. Mënyra e veprimit të këtyre mekanizmave është e butë, madje gati e pahtueshme. Përmes tyre sistemi vetëlegjitimohet. Nëse Fransis Fukuyama gaboi kur tha që demokracitë parlamentare të shoqërive të zhvilluara kapitaliste paraqesin 'fundin e historisë' si shterje e mundësive organizative politiko-shoqërore, ato, megjithatë, e heqin veten për të tilla. Po ç'është ky 'miti i lirisë'? Ç'kuptim ka 'iluzioni i zgjedhjes'? Për ta ilustruar raportin e funksionimit politik të këtyre shoqërive ndaj pafuqisë politike të individit, i ek-ut i shërben metafora e liftit. Atij i kishte rënë në sy një detaj, në shikim të parë i parëndësishëm: se në mënyrën se si funksionojnë lifat në këto shoqëri, funksionon politikisht vetë shoqëria në përgjithësi. Ta zëmë se po hyjmë në një lift të tillë. Pasi të kemi hyrë, do të vërejmë se njëra nga pullat ko-

manduese është ajo që shërben për ta mbyllur derën e liftit. E shtypim atë, dhe mendojmë që gjithçka është në rregull. Por, kujdes! - përshtypja sipas të cilës ne personalisht jemi ata që komandojmë, është një iluzion i pastër: dera e liftit është mbyllur jo si pasojë e shtypjes së kësaj pulle, por si rrjedhim i peshimit të trupit tonë në bazamentin e liftit. Dera e tij do të mbyllet jo atëherë kur ne i japim komandën, por pas asaj periudhe të caktuar pesësekondëshe ç'prej se pesha e trupit tonë rëndon lifin. E tëra që na karakterizon në një situatë të tillë është njëfarë iluzioni i pëlqeshëm i 'efektivitetit' të veprimeve tona personale. Kemi të bëjmë me një mashtrim. Dikush me të drejtë do të pyeste: po ku drejton qendroka ngjashmëria ndërmjet mënyrës së funksionimit të këtij lifti dhe shoqërive të tilla? Përgjigja s'është aspak e ndërlikuar: ndërmjet vendimarrjeve kyçe politike që realizon një elitë njerëzish në këto shoqëri, dhe rëndësisë politike të individit, ekziston një hendek i pafuqishëm. Këtij të fundit i servohet një 'spektakël zgjedhor' përplot vezullima. I krijohet përshtypja se po zgjedh diçka. Se vendimi i tij është përcaktues, se zgjedhja që bën është vendimtare. Por, ai, në të vërtetë, është fatalisht i pafuqishëm. E tëra që bën në një të tillë karnaval, s'është asgjë më shumë se shtypja e asaj pullës së liftit.

Çka do të mund të na tregonte i ek-u për vendin tonë?

Metafora e i ek-ut me të drejtë do të mund të merret si paksa ekzagjeruese. Por, ekziston një shembull që e shpëton këtë metaforë nga pasaktësia e qindpërqindtë: vendi ynë, Kosova. Një vend i administruar ndërkombëtarisht. Administrim i fundamntuar në një Rezolutë të OKB-së. Një korpus institucionesh vendore, kushti funksional i të cilave është pranimit i këtij dokumenti. Dokument në shpërputhje me vullnetin e popullit. Gjithsesi, metafora e liftit do të mund të shfrytëzohej për të shpjeguar realitetin tonë jo nga perspektiva e një shoqërie të zhvilluar kapitaliste. Aplikimi i këtij shembulli do të kufizohet, me këtë rast, vetëm për të treguar funksionimin e 'iluzionit të zgjedhjes' në shoqërinë tonë. Sistemi manipulon individin në Kosovë përmes iluzionit të zgjedhjes. Shumësia kuantitative na shitet për shumëllojshmëri cilësore. Zgjedhja këtu është e kundërta e zgjidhjes. Iluzioni i zgjedhjes reduktohet në shumësinë e alternativave. Fuqia absolute e PSSP-së shfuqizon rëndësinë politike të individit. Shkuptimëson radikalisht nevojën e tij për të zgjedhur. Ja përse, këtu te ne demokracia është reduktuar në atë që i ek-u e quan 'respek-

tim demokratik i proceseve jodemokratike'. Vlera e saj kufizohet në të drejtën e shprehjes, nëse kjo e drejtë s'përfton asnjë ndryshim konkret. Sistemi konsideron të drejtën e shprehjes si privilegjin më të lartë të individit. Ia kufizon atij kuptimin e ekzistencës në vetëmjaftueshmërinë e të drejtës për t'u shprehur. Dhe asgjë më shumë. Sipas i ek-ut, ajo që shquan kohën tonë 'perëndimore' është situimi i individit në shoqëritë e mallrave, përmbajtja e të cilave suprimohet në formë të pastër. Ja përse, sipas tij, na kanë pushtuar kafja pa kofeinë, çokollatat pa sheqer, cigaret pa duhan, birrat pa alkool, seksi pa seks (seksi virtual)... Në vendin tonë ndodh po i njëjti fenomen: kemi zgjedhjet pa liri, institucionet jointucionale, opozitën fiktive, qeverinë pa qeverisje... Ky është procesi i mashtrimit përmes përpjekjes që emërtimi të shitet si presupozim i thelbit. Vetëm e vetëm që të nënkuptohet thelbi i qeverisjes përbrenda një institucioni që quhet 'qeveri'. Procesi tjetër është maskimi i thelbit përmes ndërrimit të emërtimit: humbja e disa hektarëve tokë quhet 'demarkacion'; përgatitja për ndarjen e Kosovës quhet 'reformim i pushtetit lokal' dhe 'afrim i pushtetit më afër qytetarit'; krijimi i kushteve për ta integruar Kosovën në Unionin SMZ quhet

'integrim në Evropë'; kushtet raciste që popullit të Kosovës i vihen në mënyrë që ky t'i meritojë negociatat me Serbinë ende pa u dënuar dhuna e kësaj të fundit, quhen 'standarde civilizuese'; negociatat për negociimin e lirisë sonë kolektive dhe vullnetit të popullit quhen 'bisedime për çështje teknike'... Kosova është peng i ligjeve të funksionimit të strukturave. Këto ligje kryeneçe imponojnë individët e caktuar në krye të proceseve. Dikush, i cili pasi ka kaluar një pjesë të misionit burokratik njëvjeçar në Bosnjë, e vazhdon atë edhe për 6 muaj tjerë në Kosovë, duke ikur nga këtu, në po të njëjtën mënyrë siç erdhi. Vetëm diçka duhet të ketë ndodhur gjatë qëndrimit të tij pothuajse turistik këtu: rritja e varfërisë së popullit. Dhe plot probleme tjera. I njëjti ligj i dëmshëm strukturor karakterizon jo vetëm UNMIK-un, por edhe institucionet dhe partitë tona politike. Dhe, ky është tregimi i hidhur se si vendi ynë kontrollohet. Populli manipulohet. Thelbi i regjimit antidemokratik maskohet. Dështimi sistemik hedhet te populli, duke i vënë problemat social maskën e konfliktit etnik. Në mënyrë që populli ta përtojë këtë 'dështim' si vetëfajësi... dhe sistemi të shfajësohet.

Paralajmërimi dhe kërcënimi

Gëzim Krasniqi

Zërave dhe thirrjeve të vazhdueshme dhe të shumta të qendrave politike ndërkombëtare dhe politikanëve të huaj, që u bëjnë thirrje politikanëve dhe popullit të Kosovës të përgatiten për kompromis me Serbinë, së fundi iu shtua edhe zëri i kryeadministratorit të Kosovës, Soren Jessen-Petersen. Para pak ditësh, ai deklaroi qartë se Kosova duhet të përgatitet për kompromis, duke na bërë me dije edhe njëherë për kahjen e zhvillimeve të ardhshme politike përkritazi me përcaktimin e statusit politik të Kosovës. Më shumë sesa një risi, deklarimi i tij është një shenjë e vazhdimit të davaritjes së mjegullës (që megjithatë ekziston te një numër jo i vogël i 'qytetarëve' dhe subjekteve të ndryshme politike e jopolitike të Kosovës) rreth trajektoreve politike të bashkësisë ndërkombëtare dhe derivatit të saj në Kosovë, UNMIK-ut, në lidhje me vendin tonë dhe statusin politik të tij. Pra, gjithnjë e më shumë po bëhet e qartë se cili

është pozicioni i qendrave politike ndërkombëtare në raport me Kosovën, pozicion ky, në thelb të të cilit është kërkesa për negociatat të pakushtëzuara dhe kompromis me Serbinë. Kompromisi është i realizueshëm vetëm përmes negociatave. Kështu, më shumë sesa parakusht për kompromis, negociatat me Serbinë janë jetësim dhe legjitimim i kompromisit. Pranimi i negociatave me Serbinë për të ardhmen politike të Kosovës është pranimit i të bërit kompromis në lidhje me vullnetin e popullit për liri dhe vetëvendosje. IPVQ-të veç kanë pranuar negociatat, për vetë faktin që e kanë pranuar politikën 'standardet para statusit', që u vunë si kusht për negociatat. Me një fjalë, IPVQ-të kanë dhënë prova të mjaftueshme se janë të gatshme për të bërë kompromis me Serbinë. Në këtë kontekst, deklarimi i fundit i Petersen-it se Kosova duhet të përgatitet për kompromis, është thjesht një paralajmërim për 'qytetarët' për drejtimin që po merr procesi politik i

përcaktimit të statusit politik të vendit tonë. Për më shumë, Peterseni me paralajmërimin e tij duket t'iu ketë prishur qejfin dhe t'iu ketë 'thyer zemrat' shumë politikanëve shqiptar dhe njerëzve të tjerë në vend, që trumpetonin me të madhe se 'Kosova ka një Kryeadministrator që angazhohet shumë dhe punon pajada për interesa të shqiptarëve(!)' Është fare e qartë që Soren Jessen-Petersen paraqet jo më shumë se kryeburokratin e administratës neokolonialiste të UNMIK-ut, dhe që ai ka një kontratë pune me OKB-në, e cila kontratë kufizohet brenda Rezolutës 1244. Në anën tjetër, 'qytetarët' e Kosovës së fundi po ballafaqohen edhe me një fenomen tjetër negativ dhe të rrezikshëm - kërcënimin e hapur nga ana e KFOR-it. Fjala është për fushatën e KFOR-it për të ashtuquajturat 'zonë e kaltër' dhe 'zonë e kuqe', që do të krijoheshin në rast të trazirave në Kosovë. Përmes kësaj fushate, KFOR-i po e bën shumë të qartë faktin që në Kosovë s'ka liri, dhe që këtu s're-

spektohen të drejtat më elementare të njeriut, përfshirë të drejtën për jetë. Kjo, ngaqë në reklamat e tij që kanë pushtuar mediat në vend, KFOR-i kërcënon me përdorim të armëve në rast se njerëzit lëvizin drejt 'zonës së kuqe', gjë që nënkupton se KFOR-i kërcënon me vdekje njerëzit në Kosovë. Se çka në të vërtetë nënkuptohet me emërtimin 'zonë e kaltër' dhe 'zonë e kuqe' s'dihet saktësisht, por është shumë e qartë se me aplikimin e këtyre masave nga KFOR-i, 'qytetarët' e Kosovës do të jenë të privuar, madje edhe të rrezikuar të lëvizin lirshëm në vendin dhe në pronat e tyre. Gjithsesi, kjo fushatë kërcënimi e KFOR-it është e lidhur shumë ngushtë dhe është e sinkronizuar me projektin për decentralizim dhe paralajmërimin për domosdoshmërinë e negociatave dhe kompromisit. Kur të jetë vendosur përfundimisht për decentralizimin dhe kur të jetë bërë realitet kompromisi politik më shtetin e Serbisë, përmes aplikimit të masave të tilla kërcënuese - kri-

jimit të zonave të sigurisë, KFOR-i planifikon të garantojë realizimin praktik të tyre. Në rast të enklavizimit të Kosovës përmes procesit të decentralizimit dhe krijimit të zonave të sigurisë për serbët në Kosovë, KFOR-i përmes krijimit të këtyre zonave do të përpiqet ta pamundësojë kundërshtimin e popullatës shqiptare, qoftë kjo edhe përmes përdorimit të armëve. Në njërin anë, paralajmërimi i Petersenit për domosdoshmërinë e kompromisit si dhe kërcënimi i KFOR-it tregojnë për një nivel shumë të lartë të koordinimit që ekziston në mes faktorëve politik dhe ushtarak ndërkombëtarë në lidhje me agjendën politike për Kosovën; këto janë dy veprime të ngjashme, njëlloj të akredituara dhe që plotësojnë njëra tjetrën. Në anën tjetër, ato janë përpjekje e pashpresë për të pamundësuar lirinë në Kosovë; janë shenja të panikut dhe dobësisë së regjimit jodemokratik të UNMIK-ut përballë valës së fuqishme popullore dhe thirrjes qytetare për liri dhe vetëvendosje.

Demokracia është tash

Besnik Pula

Filozofi Henri Lefebvre, një nga mendimtarët bashkëkohorë që ktheu kategorinë e hapësirës në mendimin kritik shoqëror, thotë se hapësira është e konceptueshme në tri mënyra. Hapësira shoqërore - hapësira e marrëdhënieve shoqërore, fusha e marrëdhënieve të prodhimit, e hierarkive dhe institucioneve të organizimit social. Hapësira fizike - hapësira e botës së objekteve, e elementeve, renditjeve, zgjatjeve dhe lakimeve të tyre në botën materiale. Dhe në fund, hapësira abstrakte - hapësira e mendimit, e ideologjive, e koncepteve të pastra, aty ku dominon prirja kah universalja.

Ka kohë që gjuha zyrtare në Kosovë flet për transicionin. Shpesh thuhet se Kosova është në transicion, se Kosova përballet me vështirësi në transicionin e vetë, se transicioni po vazhdon, se është i vështirë, se është i shpejtë apo i ngadalshëm etj. etj. Transicioni lidhet me demokratizimin. Ai është koncept kohor, kështu që vetë koncepti i demokracisë është shndërruar në kategori kohore. Në fakt, manipulimi me kategorinë e kohës është aq i thellë në Kosovë, sa që lirisht mund të thuhet se përbën bazamentin e administratës ndërkombëtare. Vetë emri i saj, "e përkohshme", të bën të kuptosh se kemi të bëjmë me një lojë groteske të pushtetit me nocionin e kohës.

E futur në lojën e kohës, politika kosovare gjithmonë është mbrapa, sepse e pasmja, paskoha, është caktuar si fusha e veprimit të saj. E kaluara është ajo që i takon asaj, aq sa edhe e ardhmja - një koncept gjithashtu shumë i keqpërdorur, është një e kaluar për të. Por ç'është më e keqja, më tragjika, këtë konceptim të kohës - të transicionit dhe demokracisë në pritje, të demokracisë që akoma s'është këtu - përmes teknokracisë mediale, pushteti ndërkombëtar ia ka imponuar si bindje edhe shoqërisë kosovare. Pra, kemi të bëjmë me një ideologji mbi kohën, ideologji që është fund e krye në shërbim të burkrocisë, të kapitalizmit grabitqar, të strukturave aktuale të pushtetit anti-demokratik.

Për këtë arsye Lëvizja VETËVENDOSJE!, vetë lindja e saj, përbën një akt revolucionar. Sepse veprimet e veta e nxjerrin demokracinë

nga plani kohor, për ta futur atë në plan hapësinor. E kjo dukuri e nivelit të reales, është e papranueshme për pushtetin. Lëvizja VETËVENDOSJE! dëshmoi një gjë - se ideologjia mbi kohën, në fakt, është mbulesë për pushtetin që strukturat aktuale të pushtetit e ushtrojnë mbi hapësirën. Kohën dhe hapësirën e vet - nga të cilat qytetari është i përjashtuar - strukturat aktuale të pushtetit, treguan se janë të gatshme t'i mbrojnë edhe me dhunë. T'i mbrojnë ato nga vetë qytetarët. Sepse është pikërisht dhuna, ajo që qytetari kosovar hasë kur ndeshet me pushtetin aktual; dhuna simbolike, dhuna strukturore dhe, kur është nevoja, edhe dhuna fizike.

Lëvizja VETËVENDOSJE! përbën revolucion në të gjitha kategoritë Lefebvreiane të hapësirës: të hapësirës shoqërore, të asaj abstrakte dhe të asaj fizike. Për Lefebvre, revolucioni është krijim i një hapësire të re në të gjitha nivelet.

Në hapësirën shoqërore, sepse ajo është shtytje për një transformim radikal shoqëror, për barazi radikale dhe demokratizim radikal të të gjitha pushteteve. Vetëvendosja nuk është thjesht kërkesë për një proces teknik, nuk është e reduktueshme në referendum apo deklaram popullor (siç e interpretojnë disa doksozofë të gazetave tona), por është ftesë për emancipim total shoqëror. Sepse për nga vetë forma, lëvizja është anomali, nuk puqet me kategorinë e perceptimit që ndajnë doksozofët - kategoria e atyre që, sipas sociologut Pierre Bourdieu, merren me riprodhimin e ortodoksisë dhe skemave dominante të mendimit dhe klasifikimit - të tillë çfarë kanë mbushur redaksitë e gazetave kosovare, ku disa nën emblemin e kombëtarizmit, të tjerët nën atë të liberalizmit, mbushin faqet me variantat e diskurseve të tyre konservatore dhe autoritare. Të tillët mundohen, pa sukses, që VETËVENDOSJE!-n herë ta quajnë OJQ, herë parti, herë kërkojnë program politik nga ajo, herë e personalizojnë atë në figurën e Albin Kurtit, por nuk janë në gjendje t'ia stabilizojnë asaj një identitet. Kjo është shenjë e mirë, përdërisa vazhdon, në të njëjtën kohë është provë për atë që po thuhet këtu.

Në hapësirën abstrakte, Lëvizja VETËVENDOSJE! është paraqitur si një kolektiv të panështruarish mental, një akademi alternative e mendi-

mit, e mendimit që nuk ekziston si i tillë por që lidhet ngushtë me atë që Antonio Gramsci e quajti praxis. Teoria nuk është qëllim në vetëvete, filozofia nuk është veprimtari e luksit të tepërt apo snobizmit, por është bazë themelore për zhvillimin e praktikës, për hulumtimin e topografisë sociale, për kuptimin e fenomeneve dhe për veprimin politik.

Në hapësirën fizike, Lëvizja VETËVENDOSJE! është shkelje e kufijve, e barrierave dhe barrikadave shumë të dukshme hapësinore që pushteti aktual ka vënë midis vetes dhe qytetarëve. Parullat e VETËVENDOSJE!-s nëpër muret e ndërtesave dhe rrethojave publike kosovare nuk janë të reduktueshme në grafite artistike as në vandalizëm ordiner, por janë shprehje e mllëfit dhe pathyeshmërisë qytetare dhe popullore karshi një pushteti që ka anuluar demokracinë, përderisa vendosë për gjithçka në emër të qytetarëve.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është kundër demokracisë formale, kundër kolonializmit teknokrat post-modern dhe autoritarizmit populist neortodicional, kundër institucioneve të pushtetit që janë jo-demokratike, jo vetëm për nga forma, por edhe për nga përmbajtja. Vetë shtylla e pushtetit republikan - Kuvendi, lëre që është në pozitë asimetrike dhe të nënshtruar karshi pushtetit ndërkombëtar, por ai edhe është bërë si institucion i reduktueshëm në teket personale të kryetarit të vet. Por Michel Foucault e ka thënë drejtë: forma dhe përmbajtja nuk janë të ndara, por imponojnë dhe komplementojnë njëra-tjetrën. Pushteti nuk ndahet me thikë, ai graviton në disa qendra, funksionon përmes shumë arte-rievë, për të formuar kështu një strukturë të vetme dhe koherente, likuiduese e kontraktive brenda saj, uniforme në efektet e veta, e vrojtueshme në patologjitë personale të aktorëve që e përbëjnë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk është thirrje për revolucion, ajo është vetë revolucion. Çdo akt i saj është ndërhyrje në procesin historik, dhe jo vetëm në atë politik. Dhe çdo akt i saj po e nxjerrë në vetëdijen kolektive një gjë: demokracia më nuk është diçka që pritet, diçka që vjen, diçka që akoma s'është këtu. Demokracia është tash.



KOMENT

Mbi tri ngjarjet më të rëndësishme politike të muajit

Paskashi, Çoviqi, Plani B...

Shkëlzen Gashi

1. Pjesëmarrja e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së SMZ-së, Dragan Paskash, në ceremoninë e dorëzimit-pranimi të komandës së KFOR-it që u mbajt në bazën ushtarake të KFOR-it "Film City" në Prishtinë, shënon fillimin e fazës kur do të intensifikohet realizimi i Rezolutës 1244. Rezoluta 1244 ngërthen në vete edhe Marrëveshjen e Rambujesë, e që të dy këto dokumente parashohin kthimin e forcave ushtarake e policore serbe në Kosovë. Megjithatë një hap simbolik, prania e Paskashit në Prishtinë, e realizuar pas ftesës së bërë atij nga tashmë ish Komandanti i KFOR-it në Kosovë, Yves de Kermabon, është shumë domethënëse dhe që i paraprinë hapave tjerë konkretë. Kjo vizitë realizohet pas shumë vizitave tjera të mëparshme të zyrtarëve të lartë politikë të Serbisë (Çoviqi, Koshtunica, Tadiqi, Drashkoviqi etj.) në vendin tonë, dhe është tregues i qartë i pranisë në rritje të shtetit të Serbisë në zhvillimet politike dhe ushtarake në Kosovë. Gjithsesi, kjo vizitë nuk është e rastësishme; e gjithë kjo bëhet në ndërkohë që bëhen përgatitjet për fillimin e negociatave për kompromis dhe për implementimin e decentralizimit.

2. Deklarata e Çoviqit se negociatat për Kosovën duhet të fillojnë pavarësisht përmëshjes së standardeve është edhe një tregues serioz se 'Standardet para Statusit' (SPS) janë farsë, dhe se plotësimi, përkatësisht mosplotësimi i tyre, nuk ka për të ndikuar në procesin e përcaktimit të statusit final të Kosovës. Statusi është i përcaktuar me Rezolutën 1244. E, kjo do të thotë se statusi do të jetë në përputhje me sovranitetin dhe integritetin territorial të Unionit Serbi-Mali i Zi. Liderët e institucioneve të UNMIK-ut (lexo: IPVQ-të) dhe partive politike gënjejnë kur thonë se për statusin final të Kosovës nuk do të bisedojmë me Serbinë, por, do të bisedojmë vetëm me bashkësinë ndërkombëtare, dhe atë, për modalitetet e funksionimit të

shtetit të ardhshëm të Kosovës. Nëse është kështu, atëherë, pse liderët kosovarë kanë pranuar të futen në Forumin Politik, i cili mekanizëm është krijuar nga UNMIK-u për të vetmin qëllim: negociimin e statusit të Kosovës me Serbinë. Sipas liderëve kosovarë, Kosova do të ketë pavarësi të kushtëzuar. Pavarësia e kushtëzuar është contradictio in adjectio. Është njësoj sikur të thuhet katrori është i rumbullakët. Pavarësia e kushtëzuar është varësi.

3. Pas refuzimit të serbëve që të pranojnë planin e parë, Qeveria e Kosovës ka dalë me planin B të decentralizimit, plan ky që ndryshe nga plani i mëparshëm, parasheh krijimin e pilotkomunave të reja që përfshijnë më shumë se një zonë kadastrale. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës për të përfshirë më shumë se një zonë kadastrale në komunat e reja, është në përputhje me planet serbe për bashkimin e fshatrave të banuara me serbë në komuna të veçanta, për të krijuar parakushte për një autonomi terriotriale të vendbanimeve serbe në Kosovë. Sipas planit B për decentralizimin, parashihet që komunës së re të Graçanicës t'i bashkohet fshatrat serbe Preoc, Llapnasellë, Sushicë, si dhe Hajvalia që është e banuar me shqiptarë. Ndërsa, komunës së re të Parteshit t'i bashkohet fshati serb Budrigë e Poshtme dhe fshati Cërnica, i cili është i banuar me serbë dhe shqiptarë. Fakti që në këto dy komuna të sipërpërmendura është paraparë të përfshihen edhe vendbanime të shqiptarëve, s'është asgjë më shumë sesa një përpjekje e Qeverisë së Kosovës për të krijuar përshtypjen tek populli i Kosovës se decentralizimi nuk do të krijojë komuna të pastra etnikisht. Sidoqoftë, Parteshi dhe Graçanica do të jenë me shumicë të banorëve serbë. Në anën tjetër, serbët akoma nuk kanë pranuar këtë plan, për faktin e thjeshtë që ata tashmë e kanë atë - ata do të kërkojnë që të arrijnë deri tek implementimi i plotë i planit të Koshtunicës për decentralizimin në Kosovë.



njerëz në lëvizje
 gjeneratë me shpjegim të ri
 komunitet që refuzon të nënshtrohet
 drejt vetëvendosjes dhe deri në vetëvendosje



Kompromisi - kurorëzim i mohimit të vullnetit të popullit

Komunikatë kundër deklarimit të Soren Jessen-Petersenit për kompromis me Serbinë

Kryeadministratori Soren Jessen-Petersen e tha hapur atë që ka qenë e ditur sipas përkufizimit. Se negociatat nënkuptojnë kompromisin; se po përgatiten negociatat për Kosovën, meqenëse po përgatitet kompromisi për të. E kompromisi s'është asgjë tjetër përveçse robëri e re për Kosovën, varësi e pakushtëzuar nën Serbi.

Deklarimi i djeshëm i Soren Jessen-Petersen-it, nuk i drejtohet politikanëve të Kosovës, por popullit të Kosovës. Politika e UNMIK-ut përcaktohet nga Rezoluta 1244, e cila mohon vullnetin e popullit të Kosovës, dhe

modelohet prej presioneve të Serbisë, që synon ta rimarrë Kosovën duke e coptuar atë paraprakisht nëpërmjet procesit të decentralizimit. Për këtë politikë, politikanët e Kosovës nuk janë sfidë. Zaten, ata janë brenda institucioneve të sistemit politik që e ka krijuar dhe e kontrollon regjimi antidemokratik dhe kolonialist i UNMIK-ut. Për pasojë, janë të korruptuar dhe të shantazhuar.

Koncepti i 'Standardeve para Statusit', në kuptimin që proklamohet, gjithnjë ka qenë farsë. Ky koncept e zëvendësoi fjalën

pavarësi me fjalën status, statusin e ndaloj si temë, dhe e bëri të negociueshëm me Serbinë pas përmbushjes së standardeve. Në fakt, fillimi i negociatave gjithmonë ka qenë i pavarur nga përmbushja e standardeve. Kai Aide veçsa po vlerëson ambientin politik dhe shoqëror për fillimin e negociatave, e jo plotësimin e standardeve. Standardet kanë qenë mënyra e blerjes së kohës që nevojitej për ta transformuar vullnetin e popullit, për ta lodhur e molisur atë, për ta amortizuar atë drejt thyerjes përfundimtare. Pra, për politikën zyrtare, populli është sfida. Soren

Jessen-Petersen i drejtohet popullit të Kosovës, pengesës së vetme për kthimin e tërësishëm faktik dhe praktik të Kosovës nën Serbi.

Ajo çfarë është inkurajuar deri më tash (iluzionet për pavarësinë) tash janë shndërruar në pengesë për vet UNMIK-un, shefi i të cilit deklaroi se është iluzore që Prishtina të presë se bashkësia ndërkombëtare do t'i jap atë që ata dëshirojnë.

Soren Jessen-Petersen tha se kompromisi duhet të bëhet për hir të normalitetit dhe stabilitetit në rajon. Pra, për normalitet e stabilitet u dashka që të kënaqen

aspiratat e Serbisë, të udhëheqjes shoviniste dhe hegjemoniste të saj, dhe u nevojitka të shtypet populli i Kosovës, e të mos realizohet vullneti i tij. Ky qëndrim është fashist. Normaliteti dhe stabiliteti, sipas UNMIK-ut, ruhet vetëm nëse nuk ndryshohen kufijtë ekzistues shtetëror në Ballkan, e siç dihet kufiri mes Kosovës dhe Serbisë është kufi administrativ.

Në Kosovë nuk ka zgjidhje në rrugë institucionale. Në Kosovë ka zgjidhje në rrugë. Drejt vetëvendosjes.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!**

Kroi i Bardhë, nr. 76
Lagja Dardania
Prishtinë, Kosovë

038 541411
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org